




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 03.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 34, të datës 16.01.2020, paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 11, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

**V E N D I M**

**Për lejimin e shpenzimeve të mjeteve financiare për subvencione në bujqësi për vitin 2020**

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare në shumë prej 324,000.00€, prej 'Kodit të bashkëfinancimit, kodit të participimit, subvencioneve dhe transfereve duke e përfshirë edhe mbetjen e mjeteve financiare në shumën prej 62,174.86€, nga participimi i fermerëve në vitin 2019, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2020 si vijon:
  - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 60,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Serrave';
  - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 70,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Motokultivatorëve';
  - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 5,500.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Ciklonëve - Shpërndarësve të plehut artificial';
  - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 7,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Makinave mjelëse';
  - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 75,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor';
  - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 16,500.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Pajisjeve bletare';
  - 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 22,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Laktofrizëve';
  - 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 9,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mullinjëve';
  - 1.9 Mjetet financiare, në shumë prej 24,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Spërkatësve për traktorë';

- 1.10 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Fazanëve të egër';
  - 1.11 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Lepujve të egër';
  - 1.12 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Folive'.
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga paragrafi 1, nënparagrafët prej 1.1 e deri tek nënparagrafin 1.9, të paragrafit një të vendimit, participojnë edhe fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2020, me 20% të vlerës së projekteve.
  3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Zyrës së Prokurimit.
  4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**  
**Vjollca Konjusha**






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bt.str. 19  
Datë/Datum 04.02.2020



Datë: 03.02.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 05, të datës 16.01.2020, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, nenin 54, paragrafi 54.1, nenin 55 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete**

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 05, të datës 16.01.2020 për emërimin e z. Suhat Ademi i lindur më datë 24.02.1975 me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues nga subjekti politikë Partia Liberale Egjiptiane, në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, prej datës 29.01.2020 e deri në përfundimin e mandatit zgjedhor 2017-2021.
2. I emëruari në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij do të fillon t'i ushtron nga dita e emërimit të tij me datë 29.01.2020, konform dispozitave ligjore në fuqi.
3. Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Udhëheqëses të Personelit, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008 për pagesën e stafit politikë në komuna, të Qeverisë së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,**

**Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses të Personelit dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**







**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



|                                               |                                                                                                                                                     |  |
|-----------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|                                               | REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA<br>KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE<br>DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU |  |
| Nr./aq/Dr.str. <u>20</u>                      |                                                                                                                                                     |  |
| Data/Datum. <u>04-02-2020</u>                 |                                                                                                                                                     |  |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE |                                                                                                                                                     |  |

**Datë: 03.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 16.01.2020, paraqitur nga Kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), neni 51, paragrafi 51.1, nenin 53, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunën, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafin 34.1, shkronja (b), nenin 36, nenin 38, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018 për zëvendësimin e përfaqësuesit të subjektit politik të Partisë Liberale Egjiptiane në Komitetin për Komunitete**

1. Për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe zëvendësimin e përfaqësueses së subjektit politik të Partia Liberale Egjiptiane znj. Emine Murtezi, me anëtarin e ri z. Bashkim Krasniqi.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**  
**Vjollca Konjusha**









**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 03.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 30, të datës 16.01.2020, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë me Nr. 02-070/05-0001414/20, të datës 16.01.2020 dhe kërkesën e përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë me Nr. 02-070/05-0001402/20, të datës 16.01.2020, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2020**

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për vitin 2020 në shumë të mjeteve financiare prej 195.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2020, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 03.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 26, të datës 16.01.2020, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.2, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e Propozimit Nr. 26, të datës 16.01.2020 për lirim nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin kalendarik 2020**

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 26, të datës 16.01.2020 për lirim nga bizneset nga pagesa e taksës komunale për vitin 2020 për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe biznesore në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për ZHE dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**








**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 04.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur në Kuvendin e Komunës nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje për themelimin e Komisionit për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve në bujqësi për vitin 2020, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për refuzimin e propozimit për themelimin e Komisionit për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve në bujqësi për vitin 2020**

1. Për refuzimin e propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, për themelimin e Komisionit për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve në bujqësi për fermerët dhe ekonomitë familjare në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së BZHR, Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**  
**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



|                                                                                                                                                     |            |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA<br>KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE<br>DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU |            |
| Nr.faq/Br.str.                                                                                                                                      | 25         |
| Data/Datum.                                                                                                                                         | 06.02.2020 |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE                                                                                                       |            |

**Datë: 04.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019, sipas shkresës 020-860/6, të datës 16.10.2019, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për shtyerjen e shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019**

1. Aprovohet propozimi për shtyerjen e shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr.151, i datës 30.07.2019, deri në miratimin përfundimtar të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, e paraparë për shqyrtim dhe miratim në muajin shkurt 2020.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës  
Vjollca Konjusha**





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nrfaq/Bi.str. 26  
Datë/Datum. 06.02.2020  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 04.02.2020**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2020, pas shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 200, të datës 13.12.2019, sipas shkresës me Nr. 0201279/3, të datës 27.12.2019, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për shfuqizimin e Vendimit Nr. 200, të datës 13.12.2019**

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 200, të datës 13.12.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-1279/3, të datës 27.12.2019, lidhur me marrëveshjen për kompensimin e pronarëve: Naim Enver Nuredini, Shaban Hamit Berisha, Skender Mehdi Maliqi, për pronat e marra për realizimin e interesit publik, 'Projektit për asfaltimin e rrugës', 'Xhamia' në fshatin Sllatinë e Madhe.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP, Palëve dhe Arkivës.**


**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës  
Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 30.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.12.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 209, të datës 16.12.2019, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, paragrafi 3, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

**V E N D I M**


**Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2020**

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2020, në përbërje prej trembëdhjetë (13) anëtarëve si vijon:
  - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kryetare e grupit;
  - 1.2 Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik;
  - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
  - 1.4 Remzi Shala - Përfaqësues i LDK-së, anëtar;
  - 1.5 Durim Hajra - Përfaqësues i LVV-së, anëtar;
  - 1.6 Aida Alimi - Përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
  - 1.7 Migjen Kolshi - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
  - 1.8 Driton Ademi - Përfaqësues i NISMËS Socialdemokrate, anëtar;
  - 1.9 Ali Ismaili - Përfaqësues i Partisë së Drejtësisë, anëtar;
  - 1.10 Driton Hasolli - Përfaqësues i AKR-së, anëtar;
  - 1.11 Mehdi Lahu - Përfaqësues i PSD-së, anëtar;
  - 1.12 Hysni Hasani - Përfaqësues i PDAK-së, anëtar;
  - 1.13 Suhat Ademi - Përfaqësues i PLE-së, anëtar.
2. Detyrë e Grupit Punues është hartimi i Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2020.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të të Grupit Punues dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**








**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 30.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.12.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1274, të datës 16.12.2019, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (j, m), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 18 të Ligjit për Shëndetësisë Nr. 04/L-125, (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2013), Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (g, i), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:


**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim të ‘Planit Zhvillimor për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2020-2024’ dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik**

1. Për aprovimin në parim të ‘Planit Zhvillimor për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2020-2024’ dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, do të ofron informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik dhe të interesuarit nga fusha përkatëse e shëndetësisë lidhur me ‘Planit Zhvillimor për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2020-2024’, gjatë diskutimit publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivit.**


**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**  
**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 30.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.12.2019, pas shqyrtimit të propozimit për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 52, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, paragrafi 2, paragrafi 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komuna, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1 shkronja (a), nenin 35, nenin 37 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:


**V E N D I M**

**Për plotësimin e vendimit Nr. 12, të datës 01.02.2018 për caktimin e përfaqësuesit të subjektit politikë Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës në përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa**

1. Për plotësimin e vendimit Nr. 12, të datës 01.02.2018 për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6, për caktimin e anëtarit z. Hysni Hasani përfaqësues i subjektit politikë Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës në përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Anëtarit të Komitetit për Politikë e Financa, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**  
**Vjollca Konjusha**







**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Stamp of the Municipality of Kosovo-Polje, Directorate of Administration. It includes the number 221 and the date 31.12.2019.

**Datë: 30.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.12.2019, pas shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 187, të datës 07.11.2019, sipas shkresës 020-1139/1, të datës 27.11.2019, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**


**Për shfuqizimin e Vendmit Nr. 187, të datës 07.11.2019**

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 187, të datës 07.11.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-1139/1, të datës 27.11.2019.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP, Palës dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 12.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 06.12.2019, pas shqyrtimit të Propozimit për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti I datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (g), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (e), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012 mori:

**V E N D I M**

**Për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore në Shqipëri**

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 10,000.00€, për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri, me destinimin e mjeteve financiare për shpenzim si vijon:
  - 1.1 Shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahen për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit, të cilët humbën jetën në Durrës të Shqipërisë nga tërmeti;
  - 1.2 Shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahet për familjet e të prekurëve nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri.
2. Sigurimi i mjeteve financiare nga pika një e vendimit, të ndara në paragrafin 1.1 dhe paragrafin 1.2, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,  
Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**



**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 12.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 06.12.2019, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1180, të datës 12.11.2019, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 7, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

**V E N D I M**

**Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit të vitit 2019**

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2019', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
  - 1.1 Ilir Hasani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
  - 1.2 Doruntina Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
  - 1.3 Aida Alimi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtare;
  - 1.4 Ali Ismaili - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
  - 1.5 Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, anëtar;
  - 1.6 Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
  - 1.7 Emin Emmini - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Krijuesin e vitit 2019'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,  
Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së ARSIMIT  
dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**


**Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 12.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 06.12.2019, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1180, të datës 12.11.2019, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 8, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

**V E N D I M**


**Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2019**

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2019', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
  - 1.1 Arjeta Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
  - 1.2 Durim Hajra - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
  - 1.3 Arjana Zogjani - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
  - 1.4 Mehdi Lahu - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
  - 1.5 Ekrem Berjani - Drejtor për Zhvillim Ekonomik, anëtar;
  - 1.6 Fatlum Berisha - Zyrtar për Sport, anëtar;
  - 1.7 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Sportistët e vitit 2019'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**








**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**  
**MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



**Datë: 12.12.2019**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 06.12.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1228, të datës 25.11.2018, paraqitur nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Ligjin 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, Rregullores Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, Strategjinë për Riintegrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n) nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim, të Planit Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022 në Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik**

1. Për aprovimin në parim, të Planit Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022 në Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoritë përgjegjëse të Komunës dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, do të ofrojnë informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik lidhur me Planin Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar, në diskutimin publik.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planin Komunal i Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoritë përgjegjëse të Komunës dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Drejtorisë së SHMS, ZKKK-së dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

**Vjollca Konjusha**